


# Përkthyes për ju që jeni pacient të shërbimit shëndetësor

– E drejta për informacion në gjuhën tuaj

---

IS-1976

Tolk for deg som er pasient i helsetjenesten  
Språk: Albansk



Informacioni i mirë dhe dialogu janë të rëndësishëm që ju të merrni ndihmën dhe mjekimin e duhur. Si pacient, ju duhet të merrni informacionin e përshtatshëm për ju. Është e rëndësishme që ju të komunikoni me personelin e kujdesit shëndetësor në lidhje me shëndetin, sëmundjen dhe mjekimin tuaj.

Ligji për përkthimin (2022) përcakton se shërbimet publike duhet të përdorin përkthyes të kualifikuar kur është e nevojshme, që ju të merrni mjekimin e duhur. Personeli i kujdesit shëndetësor si infermierët, mjekët, psikologët, etj., duhet të sigurohet që ju si pacient të merrni ndihmën që ju nevojitet.

- Ju duhet të merrni informacion mbi shëndetin dhe mjekimin tuaj në një gjuhë të kuptueshme nga ana juaj
- Fjalët dhe shprehjet mjekësore mund të jenë të vështira për t'u kuptuar. Prandaj mund t'ju duhet një përkthyes pavarësisht se ju flisni pak norvegjisht
- Përkthyesi mund të jetë në të njëjtën dhomë me ju dhe personin që ofron kujdes shëndetësor, ose mund të marrë pjesë përmes telefonit ose lidhjes me video

## **Shërbimi i kujdesit shëndetësor duhet të porosisë përkthyesin**

- Shërbimi i kujdesit shëndetësor e ka për detyrë të shqyrtojë nëse juve ju nevojitet përkthyesi. Ata duhet edhe të porosisin përkthyesin
- Shërbimet e përkthimit janë falas për pacientin
- Ju që jeni në moshë madhore, te dentisti, si rregull, duhet të paguani vetë si për përkthimin ashtu edhe trajtimin dentar

## **Duhet të përkthejnë vetëm përkthyes të kualifikuar**

- Një përkthyes i kualifikuar ka aftësitë formale në përkthim
- Fëmijët nuk duhet të përdoren si përkthyes
- Pjesëtarë të familjes, miq ose të njohur nuk duhet të përdoren si përkthyes



## **Si mund të përfitoni sa më shumë nga një bisedë e përkthyer?**

- Tregojini punonjësit të shërbimit të kujdesit shëndetësor se cilën gjuhë dhe cilin dialekt parapëlqeni të flisni
- Informojeni nëse ju flisni shumë gjuhë në mënyrë të rrjedhshme
- Informojeni nëse keni nevoja të veçanta, si për shembull, dëgjim të dobët
- Përgatituni mirë për bisedën. Mund t'i shkruani pyetjet që dëshironi të diskutoni
- Të gjitha pyetjet duhet t'i drejtohen personelit të kujdesit shëndetësor, dhe jo përkthyesit
- Tregoni nëse nuk e kuptoni përkthyesin
- Përdorni fjali të shkurtra dhe flisni qartë. Kështu përkthyesi do ta ketë më të lehtë që të përkthejë me saktësi atë që thuhet
- Përkthyesi do të përkthejë vetëm atë që thuhet. Përkthyesi nuk mund të përsërisë atë që është thënë më parë gjatë bisedës
- Mos ngurroni që të mbani shënime, në mënyrë që të mbani mend atë që thuhet
- Tregoni nëse zëri/ figura janë të dobëta kur përkthyesi merr pjesë në përkthim përmes telefonit/ lidhjes me video

## **Çfarë është përkthyesi dhe cilat janë detyrat e tij?**

- Përkthyesi do të informojë mbi rolin e përkthyesit në të dyja gjuhët në fillim të bisedës
- Përkthyesi është i paanshëm dhe neutral. Kjo do të thotë se qëndrimet ose opinionet e vetë përkthyesit nuk duhet të ndikojnë në përkthim
- Përkthyesi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe shkelja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale. Kjo do të thotë se përkthyesi nuk mund t'i tregojë askujt atë çfarë është thënë gjatë bisedës. Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin vazhdon edhe pasi përkthyesi të jetë larguar nga puna
- Përkthyesi nuk duhet t'ju japë juve këshilla ose t'ju ndihmojë që t'i përgjigjeni pyetjeve. Përkthyesi duhet vetëm të përkthejë dhe të mos kryejë detyra të tjera as për pacientin dhe as për personelin e kujdesit shëndetësor
- Përkthyesi mund të bëjë pyetje ose t'ju lutet që ta thoni diçka ndryshe, në rast se ka ndonjë gjë që përkthyesi nuk e kupton

# Keni ndonjë ankesë që nuk u përdor përkthyes në shërbimin e kujdesit shëndetësor? Keni pyetje në lidhje me të drejtat tuaja?

## Kontakttoni me:

Avokati i Popullit për pacientët dhe përdoruesit e shërbimeve sociale në qarkun ku ju banoni

[www.pasientogrukerombudet.no](http://www.pasientogrukerombudet.no) telefon 40 50 16 00

Avokati i Popullit për barazinë dhe antidiskriminimin, telefon 23 15 73 00

[Faqja e parë LDO](#)

Organizata kundër Diskriminimit nga Institucionet Shtetërore (OMOD)

[kontakt@omod.no](mailto:kontakt@omod.no) dhe [www.omod.no](http://www.omod.no)

Inspektorati shëndetësor në qarkun ku ju banoni [Inspektorati shëndetësor mbikëqyr shërbimin e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet sociale dhe shëndetësore | Inspektorati shëndetësor](#),

Telefon centrali: 21529900

## Keni ankesa ndaj cilësisë dhe kualifikimit të përkthyesit?

Ankesat mund t'i drejtohen institucionit ku jeni pacient, ose te Drejtoria e Përgjithshme e Integritetit dhe Diversitetit (IMDi) i cili është institucioni kombëtar përgjegjës për fushën e përkthimit.

[Përkthimi në sektorin publik | IMDi](#)

## Aktet ligjore mbi të drejtat e pacientëve dhe detyrat e personelit të kujdesit shëndetësor në lidhje me përdorimin e përkthyesit

Ligji për të drejtat e pacientit dhe përdoruesit të shërbimeve sociale

[Ligji për të drejtat e pacientit dhe përdoruesit të shërbimeve sociale \(Ligji i pacientit dhe përdoruesit\) – Përmbledhja e legjislacionit në fuqi](#)

Ligji për personelin e kujdesit shëndetësor

[Ligji për personelin e kujdesit shëndetësor, etj. \(Ligji për personelin shëndetësor\) – Përmbledhja e legjislacionit në fuqi](#)

## Ligji për përkthimin

[Ligji për përgjegjësinë e organeve publike në përdorimin e përkthyesit, etj. \(Ligji për përkthimin\) – Përmbledhja e legjislacionit në fuqi](#)

**Kjo broshurë gjendet në shumë gjuhë dhe mund të shkarkohet nga:**

[www.helsenorge.no](http://www.helsenorge.no) dhe [www.helsedirektoratet.no](http://www.helsedirektoratet.no)